

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“STUDIO Numër 3” SH.P.K., DATË 10.06.2023

Sot, në datën 10.06.2023, Trebla Muso, shtetas shqiptar, i lindur më 06.12.1988 në Progër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit pasaportë me nr.BD2694357 dhe nr. Personal I81206072E, në cilësinë e ortakut themelues, vendosi themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar “STUDIO Numër 3” Shpk. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi, si Shtojca A.

NENI 1– EMËRTIMI

1.1 Shoqëria emërtohet “STUDIO Numër 3” Shpk.

NENI 2 – FORMA

2.1 Shoqëria “STUDIO Numër 3” Shpk themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 3 – SELIA

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: *Njësia Bashkiake Nr. 6, Rruga “Konferenca e Pezës” Nr.111, Tiranë, Shqipëri.*

3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresa të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresa sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

NENI 4 – OBJEKTI

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston:

(i) në kryerjen e aktiviteteve të marketingut



- (iii) në kryerjen e cdo aktiviteti të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, i cili konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për arritjen e objektivave të saj, dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- (iv) në financimin, ose gjetjen e formave të financimit, duke përdorur mënyra të ndryshme për realizimin e investimeve, përfshirë edhe pjesëmarrjen në shoqëri të tjera, shitjen dhe blerjen e asetëve dhe pasurive të paluajtshme, vendosjen e tyre si garanci dhe bashkëpunimin me institucione financiare, të lidhura dhe me qëllim realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 5 – KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i ndarë në 1(një) kuotë të zotëruar nga Ortaku i Vetëm Themelues, Trebla Muso, në masën 100% (njëqind përqind) të kontributit në kapital.
- 6.2 Kuotat e Ortakëve të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 6.3 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga nga Ortaku i Vetëm Themelues, Trebla Muso, në masën 100% (njëqind përqind).
- 6.4 Secili nga Ortakët e Shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojnë/në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet

automatikisht edhe për një vit tjetër.



8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.

8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme (“ad negotia”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.

8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

Trebla Muso, shtetas shqiptar, i lindur më 06.12.1988 në Progër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit pasaportë me nr.BD2694357 dhe nr. Personal I81206072E.

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër	Nënshkrimi
	

NENI 9 – GJUHA

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2(dy) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT


10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

* * *

“STUDIO Numër 3” sh.p.k.

ORTAKU I VETËM THEMELUES:

Trebla MUSO



SHTOJCA A

STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“STUDIO Numër 3” SH.P.K., DATË 10.06.2023

KAPITULLI I

EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

NENI 1 – EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Shoqëria emërtohet si “STUDIO Numër 3” Shpk.
- 1.2 Shoqëria “STUDIO Numër 3” Shpk themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet me anë të këtij Statuti, Aktit të Themelimit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

NENI 2 – SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën *Njësia Bashkiake Nr. 6, Rruga “Konferenca e Pezës” Nr.111, Tiranë, Shqipëri.*
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresa sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

NENI 3 – OBJEKTI

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston:
 - (i) në kryerjen e aktiviteteve të marketingut
 - (ii) në kryerjen e cdo aktiviteti të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, i cili konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për arritjen e objektivave të saj, dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - (iii) në financimin, ose gjetjen e formave të financimit, duke përdorur mënyra të ndryshme për realizimin e investimeve, përfshirë edhe pjesëmarrjen në shoqëri të tjera, shitjen

dhe blerjen e asetëve dhe pasurive të paluajtshme, vendosjen e tyre si garanci dhe bashkëpunimin me institucione financiare, të lidhura dhe me qëllim realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 4 – Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI II KAPITALI, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

NENI 5 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i ndarë në 1(një) kuotë të zotëruar nga Ortaku i Vetëm Themelues, Trebla Muso në masën 100% (njëqind përqind) të kontributit në kapital.
- 5.2 Kapitali është nënshkruar dhe do të shlyhet nga Ortaku i Vetëm Themelues si më poshtë:
 - **Trebla Muso**, shtetas shqiptar, i lindur më 06.12.1988 në Progër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit pasaportë me nr.BD2694357 dhe nr. Personal I81206072E, **100 (njëqind) lekë.**
- 5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara, Ortakët Themelues, zotërojnë kapitalin e Shoqërisë sipas raporteve të përcaktuara më poshtë:

Ortaku	Kuota	% në Kapital	Vlera
Trebla Muso	1 (një)	100	100 lekë

NENI 6 – ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

- 6.1 Rritja e kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, pa kufizim, përmes kontributit në para, në natyrë apo me kredi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë.



- 6.2 Rritja e kapitalit konsiderohet e kryer në momentin kur kuotat e emetuara dhe të nënshkuara më parë janë shlyer tërësisht.
- 6.3. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.
- 6.4 Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE


- 7.1 E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pasi të jetë ezauruar e drejta e parablerjes e ortakëve të shoqërisë.
- 7.2 Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një palë të tretë, me ose pa pagesë, përveçse kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËT

Neni 8 – Asambleja e Përgjithshme, të drejtat e pjesëmarrjes dhe votës, thirrja

- 8.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, në të cilën marrin pjesë gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 8.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të votojë, në përputhje me përqindjen e zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër, ortak dhe jo ortak, i pajisur me një prokurë të posaçme, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, prokura do të mund të lëshohet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të saj.
- 8.4 Ortaku nuk mund të japë prokurë vote për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për një pjesë të saj.
- 8.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj. Pranohet mundësia që mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të zhvillohet me



video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës. Pas verifikimit të elementeve të mësipërme, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, mbledhja do të quhet e zhvilluar në vendin ku Kryetari i mbledhjes dhe Sekretari, njëkohësisht kanë qenë të pranishëm.

- 8.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret prej Administratorit/ve, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkesë të shkruar drejtuar Administratorit/ve. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet të paktën një herë në vit brenda muajit të gjashtë të vitit financiar, me qëllim që të diskutojë, analizojë dhe miratojë bilancin vjetor, raportin e administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).
- 8.7 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje apo me postë elektronike dërguar në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë.
- 8.8 Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mblidhet.
- 8.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm apo i përfaqësuar me prokurë dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë së thirrjes.
- 8.10 Nëse përmbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari, në mënyrë që të aprovojnë zbardhjen dhe nënshkrimin e procesverbalit mbi librin përkatës.



- 8.11 Në thirrjen e mbledhjes së Asamblesë e Përgjithshme duhet të jenë të përcaktuar vendet, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, apo me video/telekonferencë nën kujdesin administratorit të Shoqërisë, ku Ortakët do të mund të mblidhen.
- 8.12 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga një Kryetar i emëruar nga Ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Nëse prania e një noteri nuk është e kërkuar nga kuadri ligjorë në fuqi, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë Ortak.
- 8.13 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e Ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamble, dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.
- 8.14 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë duhet të përgatiten menjëherë pas Asamblesë dhe duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi. Lista e pjesëmarrësve i bashkëlidhet procesverbalit të mbledhjes si dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët, është/janë përgjegjës për mbajtjen e kopjes së dokumentacionit të sipërcituar.

Neni 9 –Kompetencat e Asamblesë dhe Kuorumi


- 9.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:
- a. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - b. ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
 - c. transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj në çdo formë tjetër;
 - d. pjestimin e kuotave të Shoqërisë dhe anulimin e tyre;
 - e. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe planit strategjik të zhvillimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga Administratori, përfshirë raportimet financiare;
 - f. miratimin e buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshimi të tyre;
 - g. miratimin e pasqyrave financiare në mbyllje të çdo viti ushtrimor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;



- h. miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;
 - i. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit, si dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - j. emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - k. miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
 - l. miratimin e krijimit të shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimeve të cilit do lloji qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtash apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja;
 - m. blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënien e kontributit në kapitalin e shoqërive të tjera;
 - n. miratimin e kërkesave të reja dhe rinovimin e kërkesave ekzistuese për financimin Shoqërisë apo subjekteve/palëve të treta;
 - o. vendosjen e barrëve, hipotekës, pengut apo garanci të çdo lloji tjetër mbi pasuritë e Shoqërisë;
 - p. dhënien e çdo garancie ose nënshkrimin e çdo marrëveshje të tjetër për të siguruar përmbushjen e detyrimeve financiare ose jo financiare ndaj të tretëve, për vlera më të mëdha se 100' 000 EUR;
 - q. shitjen e shoqërisë ose degëve të saj;
 - r. shitjen, blerjen apo shkëmbimin e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë.
- 9.2 Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 9.3 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirrjen e parë për mungesën e njërit prej Ortakëve, Asambleja e Përgjithshme do të thirret sërish brenda 7 (shtatë) ditësh me të njëjtin rend dite.

Neni 10 – Administratori/ët

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht me përgjashtim të rastit kur



parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojnë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.

10.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë dhe ushtron/jnë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme/ aktet e emërimit të tyre. Përveç kompetencave të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare përmes këtij Statuti, Administratori ka të drejtë të hartojë, formalizojë dhe komunikojë procedurat e brendshme, urdhrat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij Statutit dhe/ose si detyrim i legjislacionit në fuqi për fusha të caktuara nga të cilat ndikohet veprimtaria e Shoqërisë, ose që prodhojnë detyrime/ të drejta për të.

10.3 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë të posaçme (“ad negotia”) kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.

10.4 Caktohet si Administrator i parë i Shoqërisë:

Trebla Muso, shtetas shqiptar, i lindur më 06.12.1988 në Progër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit pasaportë me nr.BD2694357 dhe nr. Personal I81206072E,

Neni 11 – Eksperti kontabël i autorizuar

11.1 Nëse kërkohet nga ligji ose një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, pasqyrat financiare dhe librat kontabël të Shoqërisë do të kontrollohen/ auditohen nga një apo më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

11.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të revokohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI USHTRIMOR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE



Neni 12– Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 12.1 Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 12.2 Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe përfundon më 31 Dhjetor, të të njëjtit vit.
- 12.3 Pasqyrat financiare dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratori dhe raporti që hartohet nga eksperti kontabël i emëruar (në rast se është emëruar një i tillë), miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 12.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i këtij vitit.

Neni 13 – Fitimet

- 13.1 Fitimet neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, i shpërndahen Ortakëve në përpjesëtim me pjesët takuese të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 13.2 Asambleja, gjithashtu, mund të vendosë të mbajë shuma të caktuara si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve, tërësisht apo pjesërisht për vitin/et ushtrimore pasardhës.

KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 14 – Shpërndarja

- 14.1 Shoqëria shpërndahet në përfundim të afatit të saj parashikuar në Statut apo edhe përpara këtij afati, në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e parashikuar për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.
- 14.2 Shoqëria nuk shpërndahet në rast paaftësie, vdekjeje apo falimentimi të ortakëve.

Neni 15 – Likuidimi

- 15.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në procedurën e likuidimit.
- 15.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivitet dhe aktivitet të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.



- 15.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim në lidhje me bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuidatorit dhe mbi përfundimin e procedurës së likuidimit.
- 15.4 Pas kryerjes së pagesës së kreditorëve/ëve dhe tërheqjes së kredive, likuidatori/ët do të shpërndajnë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, proporcionalisht me kuotat që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.

KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 16.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtyre dispozitave të këtij Statuti, midis ortakëve ose midis një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen me marrëveshje mes palëve. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me marrëveshje, palët mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 17 – Dispozitat ligjore në fuqi

- 17.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.
- 17.2 Autorizohet administratori i shoqërisë që të regjistrojë Shoqërinë në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Miratuar nga:

Ortaku i Vetem Themelues:

Trebla MUSO
